

Në bazë të nenit 10 paragrafi 1 dhe paragrafi 6 nga Rregullorja e punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (tekst i pastruar) nr.01-3732/1 nga data 29.07.2019, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në mbledhjen e 36-të të mbajtur më datë 29.09.2022, në lidhje me Informatën nr.03-3495/2 nga data 27.09.2022, në Lidhje me Kërkesën e stacioneve komerciale në nivel shtetëror, e miratoi si vijon:

## **KONKLuzion**

1. Këshilli i Agjencisë e pranoi Informatën në lidhje me Kërkesën e stacioneve komerciale në nivel shtetëror, nr.03-3495/2 nga data 27.09.2022.

2. Duke marrë parasysh ngjarjet aktuale me krizën energjetike dhe rritjen e madhe të çmimit të energjisë elektrike që drejtpërdrejtë reflekton edhe në funksionimin dhe qëndrueshmërinë ekonomike të radiodifuzerëve dhe duke marrë parasysh rolin e konsiderueshëm që e kanë mediumet për pluralizmin dhe zhvillimin e shoqërive demokratike, Këshilli e miratoi konkluzionin në vijim:

- Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele të sigurojë ndihmë financiare – donacion për radiodifuzerët që do të realizohen përmes uljes prej 25% të kompensimit të tyre për lejen e emetimit të radios dhe televizionit për vitin 2023, të përlogaritur sipas formulës së përcaktuar me Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, dhe

- të dorëzojë shkresë deri te Qeveria nëse ajo ka mundësi që të sigurojë ndihmë financiare për mbulimin e shpenzimeve për distribucionin e sinjalit të të gjithë radiodifuzerëve.

3. Një ekzemplarë i Konkluzionit të dorëzohet deri te:

- Udhëheqësit e të gjithë sektorëve të Agjencisë;
- Seksionit për Përkrahjen e Punës së Këshillit dhe Agjencisë;
- Sektorit për Përkrahje Informatike dhe Punë të Përgjithshme – Arkivi i Agjencisë.

**Nr. 02-3546/4**  
**29.09.2022**  
**Shkup**

**Agjencia për shërbime Mediatike**  
**Audio dhe Audiovizuele**  
**Kryetar i Këshillit,**  
**Lazo PETRUSHEVSKI, d.v**